



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 213, Datë 28.12.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES MBI
KUSHTET SPECIFIKE PËR NDËRPRERJEN E FURNIZIMIT ME ENERGJI
ELEKTRIKE TË KLIENTËVE NË NEVOJË”**

Në mbështetje të neneve 16; nenit 84, pika 1, gërma d; nenit 95 dhe 96 pika 5, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM-së me Nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e Kushteve për Vendorsjen e Detyrimit të Shërbimit Publik që do të zbatohen ndaj të licensuarve në Sektorin e Energjisë elektrike të cilët ushtrojnë Aktivitetin e Prodhimit, Transmetimit, Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike “ dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorive Teknike mbi Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për Kushtet Specifike për Ndërprerjen e Furnizimit me Energji Elektrike të Klienteve në Nevojë”,

Konstatoi se :

- Neni 96 pika 5, i Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, përcakton se: “Furnizuesi, që furnizon me energji elektrike klientin në nevojë, mund të ndërpresë shërbimin, bazuar në kushtet specifike për këtë kategori klientësh, të miratuara nga ERE”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullores për Kushtet Specifike për Ndërprerjen e Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve në Nevojë”.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI